



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1265/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Xhema” Shpk, me nr. Biznesi 810177859, me seli ne rr. “Vëllezërit Fazliu” Prishtinë, përfaqësuar nga avokat Jeton Osmani sipas autorizimit, kundër debitorit “EXDC-US” shpk, me nr. Biznesi 81012856, mes seli ne Prishtinë , Kalabri EXD 3 La-12, nr.1 “R Krasniqi”, LL.c.nr.39, me pronar B.S., duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.393/22 të datës 28.07.2023, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “Xhema” Shpk, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.393/22 i datës 28.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.393/22 të datës 28.07.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “EXDC-US” shpk, ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.474/20 dt.20.02.2020, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku ne Prishtinë, si dhe e ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te LPK, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta anuloj ose ta ndryshoj, prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta detyroj debitorin ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori me pretendimin se arsyet e dhëna nga kreditori nuk qëndrojnë, propozon qe gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj si te pabazuar ankesën e kreditorit dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetoj, ndërsa shpenzimet e procedurës i kërkon sipas tarifës se avokatëve te Kosovës.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139

për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Xhema” Shpk, me nr. Biznesi 810177859, me seli ne rr. “Vëllezërit Fazliu” e Prishtinë, me datën 20.02.2020 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit EXDC-US” shpk, me nr. Biznesi 81012856, mes seli ne Prishtinë, Kalabri EXD 3 La-12, nr.1 “R Krasniqi”, LL.c.nr.39, me pronar B.S., në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.1301-20 dt.13.01.2020. Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.474/20 dt.20.02.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 15,184.20 €, me kamatë ligjor prej 8% e cila llogaritet nga data 13.01.2020 deri ne pagesën definitive, ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te urdhrin përmbartimor, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrin përmbartimor, debitori, ka ushtruar prapësim me arsyetimin se fatura e bashkëngjitur propozimit për përmbartim nuk përmban elementet bazike te parapara me ligjet ne fuqi, e njëjta nuk është e nënshkruar nga debitori dhe detyrimi që të paguhet një faturë e papranuar cënon parimin e sigurisë juridike, konsideron se një faturë e tille është fiktive, propozon që gjykata ta aprovoj ne tërësi prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbartimor dhe ta detyroj kreditorin t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori ne prapësim sepse debitori e ka pranuar faturën përmes postës me datën 17.01.2020 dhe asnjëherë nuk i ka kontestuar dhe ne kuptim te nenit 103 te LPK një dorëzim i tillë kuptohet dorëzim i rregullt, debitori kundërshton vetëm paramasën dhe parallogarit dhe assesi punët e kryera nga kreditori, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta lë ne fuqi urdhrin përmbartimor dhe ta detyroj debitorin ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.393/22 dt.28.07.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor, ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Fatura nr.1301-20 dt.13.01.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë se dokumenti në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se fatura është pranuar nga ai.

Andaj, duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore apo dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dhoma e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim nga debitori, por as vulën e tij. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë një dokument i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nuk e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori dhe apo vulën e debitorit. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Edhe prova tjetër e bashkangjitur ndërkohë nga kreditori fletë kthesa e Postës, nuk e validon pranimin e faturës përderisa ajo nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i debitorit, por eventualisht ka mundur të pranohet vetëm dërgesa postare në të cilën ka mundur të jetë fatura. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të dërgesës postare por assesi të faturës.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, shqyrton pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me raporte juridike me debitorin por vlerëson se e njëjta nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Pra gjykata në këtë procedurë shqyrton vetëm rregullsinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, ashtu qe hyrja në raport juridik me palët debitore dhe iniciimi i procedurës përmbarimore nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 29 par.3 të LPP-së.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE e KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1265/23 datë 13.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha